

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: - " Mbrojtja e lagjes Noneve nga gerryrja e Perroit te Gostimës, Fshati Polis Valë, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Elbasan” (Faza e dyte).

Vendndodhja : Fshati Polis Valë, Njesia Administrative Shushicë, Elbasan

Qellimi: Mbrojtja e tokave bujqesore dhe lagjes se Noneve nga vershimet e perroit te Gostimes ne fshatin Polis Vale ne menyre qe te nderpritet avancimi i gerryerjes se brigjeve i cili mund te sjellr rrezikimin e banesave prane Perroit Gostime.

Hartimi i projektit " Mbrojtja e lagjes Noneve nga gerryrja e Perroit te Gostimës, Fshati Polis Valë, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Elbasan” (Faza e dyte), synon mbrojtjen e tokave bujqesore dhe shtepive te disa familjeve ne lagjen e Noneve ne fshatin Polis Vale ne dy pika ku paraqitet si me emergjente pasi vershimi i lumit ka bere qe te gerryej brigjet duke rrezikuar keshtu qe lumi te gerryej dhe zvogeloje token bujqesore dhe ti afrohet dhe shtepive te banimit.

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES

Perroi i Gostimes eshte nje perrua teper i rrembyeshem dhe i eger i cili ka nje pjerresi relativisht te madhe 1.7% deri 5%, dhe gjate periudhes se dimrit sjell prurje te medha te ujit por edhe te sedimenteve te ngurta me nje shpejtesi te madhe duke bere keshtu qe te gerryej brigjet ne te dy anet e tij ku kalon dhe te rrezikoje tokat dhe shtepite.

Kjo ka bere vershimet e perroit te marrin gjithmone e me shume tokat e fshatit Polis Vale qe ndodhen ne brigje te lumit dhe duke iu afruar gjithmone e me shume shtepive te lagjes se Noneve. Hartimi i projektetit bëhet që penelat terthore qe do te ndertohen te mbrojne tokat dhe shtepite ne Me poshte jane edhe disa fotografi nga gjendja aktuale e perroit.







Fig.1 Foto te gjendjes ekzistuese

QËLLIMI I PROJEKTIT

Ky projekt kryhet për mbrojtjen e lagjes se Noneve dhe mbrojtjen dhe riaftesimin e tokes bujqesore.

Të hartohet projekti i zbatimit te ndertimit te penelave terthore te cilet do te bejne te mundur mbrojtjen e tokes bujqesore qe ndodhet ne brigjet e lumit nga gerryerja.

Të realizohet planifikimi i mirëmbajtjes periodike vjetore nga ana e pronarit , përfituesit dhe investitorit që në këtë rast është Bashkia Elbasan, në mënyrë per ruajtjen e investimit të kryer në këtë objekt si dhe funksionimin e tij.

METODIKA E HARTIMIT TË PROJEKTIT

Në mënyrë kronologjike projekti ka kaluar në këto faza:

- ✦ Është filluar me azhornimin paraprak për përcaktimin e pikave me emergjente qe duhen trajtuar.
- ✦ Është bërë azhornimi topografik .
- ✦ Është bërë ballafaqimi i topografisë me gjendjen aktuale duke shkelur të gjithë gjatësinë e bregut te lumit qe paraqitet me probleme.

- ✦ Përpunimi i materialeve në nivel projekt zbatimi duke hartuar një planimetri me të gjitha veprat egzistuese dhe të reja ne Sh. 1:1.000
- ✦ Profilet terthore te penelave Sh. 1:1.00
- ✦ Detaje SH. 1:25 – 1:50

VOLUMET E PUNIMEVE

Ndertimi i argjinatures gjatesore me mure gabjoni me gure kave per mbrojtjen e tokes bujqesore nga gerryerja përfshin pastrimin e vendeve nga shkurret, gërmimin dhe riseksionim e themeleve per vendosjen e argjinatures gjatesore dhe penelave terthore duke patur kujdes per mos krijimin e problemeve dhe respektimin e rregullores se sigurimit Teknik per punimet ne argjinatura mbrojtese.

Volumet e punimeve janë nxjerrë nga planimetria dhe sipas seksioneve tërthore.

Janë bërë llogaritjet e kuotave, të tabanit dhe kuota e projektit me qëllim funksionimin sipas parametrave të projektuar për seksionet.

KONKLUZIONE

Në përfundim të projektit te zbatimit për objektin në studim për rehabilitim konkludojmë si më poshtë:

1. Janë hartuar plan rilevimi, planimetritë e ndertimit te panelave mbrojtjes, profilat tërthor e gjatesor te paneleve e detaje.
2. Preventivi i zbatimit është vlerësuar sipas V.K.M. Nr.216 datë 13.04.2023.
3. Analizave të çmimeve dhe normativave të tregut në Rajonin Elbasan

REKOMANDIME

1. Përpara fillimit të punimeve duhet të bëhet piketimi sipas gjendjes së momentit kur jepet investimi.
2. Të bëhet edhe njëherë azhornimi topografik para fillimit të punimeve dhe të krahasohet me profilat terthorë te projektit
3. Të zbatohen me korrektësi KTP dhe KTZ gjatë punimeve, çdo ndryshim në projekt të bëhet në miratim të plotë me investitorin dhe projektuesin në rastet që do të jetë e nevojshme një gjë e tillë.

PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi i punimeve, specifikimet për objektin " Mbrojtja e lagjes Noneve nga gerrytja e Perroit te Gostimës, Fshati Polis Valë, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Elbasan" (Faza e dyte) , jane bashkëlidhur projekt-zbatimit që shoqëron këtë relacion.

Punoi: Ing.Arian Baku
Ing.Armand Topi

MIRATOI
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE
Ndricim Sinani